



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:270536

Datë: 14.02.2024

Numri i dokumentit: 05327564

P.2023:270537

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK - Gjyqtari Burim Çaka në çështjen penale kundër të pandehurit: D.H, i akuzuar për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj me numër PP/II.nr.1557/23 të datës 04.12.2023, sipas detyrës zyrtare, më datë 14.02.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. Hedhet poshtë Aktakuza e Prokurorisë Themelore Ferizaj me PP/II.nr.1557/23 e datës 04.12.2023 ndaj të pandehurit D.H për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 paragrafi 1 të KPRK-së

II. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.1557/23 të datës 04.12.2023, ndaj të pandehurit D.H për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata më datë 15.12.2023 ka marrë aktvendim P.2023:270537 me të cilën ka kërkuar nga Prokuroria Themelore Ferizaj që në afat prej 15 ditësh të bëjë plotësimin e aktakuzës

PP/II.nr.1557/23 të datës 04.12.2023 dhe e ka njoftuar lidhur me pasojat për mos plotësimin e sajë.

Gjykata ka kërkuar nga Prokuroria Themelore Ferizaj me afat të mjaftueshëm dhe të aryeshëm që të bëjë plotësimin e aktakuzës në këto pika:

1. Për të pandehurin D.H të ofrohet si provë: marrja në pyetje e të pandehurit me autorizim nga ana e Prokurorisë së Shtetit i dhënë policisë së Kosovës sipas nenit 149 paragrafi 1 të KPP-së, **para ngritjes së aktakuzës.**
2. Në dispozitiv të aktakuzës të përcaktohet se prej cilit numër të telefonit në cilin numër të telefonit e ka thirrë ose shkruajtur në telefon i pandehuri palën e dëmtuar; dhe të bashkëngjisë listën e thirrjeve apo të shkrimeve telefonike, apo të përshkruaj në qfarë forme tjetër ka komunikuar.
3. Të rekomandimet për provat e administruara në aktakuzë **të listoj provat një nga një**, të cilat rekomandon që të administrohen.

Me këtë arsyetim: Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës, ka vërejtur se në shkresat e lëndës mungon: Prova – marrja në pyetje e të pandehurit të dhënë në polici, me autorizim të prokurorit të shtetit, sipas nenit 149 paragrafi 1 të KPP-së, pasi që në mungesë të autorizimit para ngritjes së aktakuzës nuk mund të vazhdohet tutje në shqyrtimin e lëndës, pasi që e njëjta është pengesë e pa kalueshme ligjore e paraparë në nenin 149 par 1 të KPP-së.

Gjykata po ashtu ka vërejtur se dispozitivi i aktakuzës nuk është përpiluar sipas nenit 235 paragrafi 1 pika 1.5 të KPP-së, pasi që mungojnë të dhënat themelore, në këtë rast numrat e telefonit nga cili në cilin është bërë thirrja apo shkrimi dhe mungon lista e thirrjeve apo shkrimeve në shkresat e lëndës, apo të përshkruaj në qfarë forme tjetër të komunikimit është bërë ngacmimi.

Gjykata po ashtu ka vërejtur se dispozitivi i aktakuzës nuk është përpiluar sipas nenit 235 paragrafi 1 pika 1.6 të KPP-së, pasi që nuk janë listuar provat që rekomandohen të

administrohen. Formulimi (të administrohen *si dhe shkresat e tjera të lëndës*), nuk është në përputhje me këtë nen.

Prokurori e shtetit më datë 05.01.2024 ka kërkuar zgjatjen e afatit për plotësim, të cilin gjykata ia ka lejuar deri më datë 31.01.2024.

Prokurori e shtetit më datë 31.01.2024 ka kthyer përgjigje, por nuk i ka plotësuar të dhënat të cilat i ka kërkuar gjykata me Aktvendimin P.2023:270537 të datës 15.12.2023.

Prokuroria e shtetit në përgjigje ia ka bashkangjitur gjykatës Procesverbalin e marrjes në pyetje të pandehurit me autorizim të prokurorit të shtetit të datës 10.01.2024.

Gjykata vlerëson se Prokuroria Themelore Ferizaj nuk ka vepruar sipas Aktvendimit P.2023:270537 të datës 15.12.2023, aktakuzën nuk e ka plotësuar si në pikat e kërkuara.

Gjykata kur e ka kthyer aktakuzën në plotësim për pikën 1 me aktvendimin P.2023:270537 të datës 15.12.2023, nuk e ka kthyer në lëndën në fazën hetimore, veprim hetimor të cilin prokuroria e shtetit e ka pasur për obligim ta bëjë para ngritjes aktakuzës, por ka kërkuar që të prezantohet si provë- marrja në pyetje e të pandehurit me autorizim nga ana e Prokurorisë së Shtetit i dhënë policisë së Kosovës sipas nenit 149 të KPP-së, **para ngritjes së aktakuzës**, ndërsa me autorizim të Prokurorisë së shtetit i pandehuri është marrë në pyetje më datë 10.01.2024 pas ngritjes së aktakuzës, ku aktakuza është ngritur më datë 04.12.2023.

Faktin se aktakuza PP/II.nr.1557/23 e datës 04.12.2023 është ngritur pa autorizim të prokurorit të shtetit, të njëjtën e ka pohuar edhe vet prokuroria e shtetit me kërkesën drejtuar policisë të datës 21.12.2023 të bashkëngjitur me parshtresën e datës 29.12.2023.

Gjykata ka vlerësuar se po ashtu Prokuroria e shtetit nuk e ka plotësuar edhe për pikat 2 dhe 3 të aktvendimit P.2023:270537 të datës 15.12.2023, ku Gjykata ka vërejtur se dispozitivi i aktakuzës nuk është përpiluar sipas nenit 235 paragrafi 1 pika 1.5 të KPP-së, pasi që mungojnë të dhënat themelore, në këtë rast numrat e telefonit nga cili në cilin është bërë thirrja apo shkrimi dhe mungon lista e thirrjeve apo shkrimeve në shkresat e lëndës, apo të përshkruaj në çfarë forme tjetër ka komunikuar. Gjykata po ashtu ka vërejtur se dispozitivi i aktgjykimit nuk

është përpiluar sipas nenit 235 paragrafi 1 pika 1.6 të KPP-së, pasi që nuk janë listuar provat që rekomandohen të administrohen. Formulimi (të administrohen *si dhe shkresat e tjera të lëndës*), nuk është në përputhje me këtë nen.

Andaj në bazë të nenit 149 paragrafi 1 të KPP-së, 235 paragrafi 1 pika 1.5, 1.6, 357 paragrafi 1 pika 1.3 dhe 441 paragrafi 4 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DEGA KAÇANIK,

P.2023:270537 datë 14.02.2024

Gjyqtari:

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.